



Pranuar / Dorezuar Punjtens/Prodato Received/Delivered	13.02.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendis	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK	1707/2023		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.176/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.280/22, të datës 13.01.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.176/2020 të datës 29.06.2020, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi rruga "Agim Ademi", Komuna e Prishtinës kundër/Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 13.02.2023, mori këtë:

### V E N D I M

**SHPALLET** jo kompetent Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.176/2020 e datës 29.06.2020 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi me datën 29.06.2020 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1240/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit kundër me numër Nr.411-2/1K të datës 06.08.2020 për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave procedurale dhe vërtetimit të gabuar apo jo të plote të gjendjes faktike.

Ankuesi ka qenë i punësuar Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, sipas kontratës së punës me numër 415-ref 5/2-1-300 të datës 01.07.2009 në pozitën "Asistent i transportit", pranë Departamentit të infrastrukturës dhe shërbimeve teknike, Divizioni-Njësia e transportit.

Me datën 01.09.2009, Ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Përhershëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka nxjerrë vendimin me numër 344/2, sipas të cilit ankuesi është risistemuar në pozitën asistent i transportit (vozitës) në kabinetin e ministrit duke i shtuar edhe shtesën në vlerë prej njëqind (100) eurove, sipas të cilit vendim i është lëshuar edhe kontrata e punës.

Me datën 01.02.2016 Ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Përhershëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka nxjerrë vendimin me numër Nr.2-183, sipas të cilit është ndryshuar dhe plotësuar vendimi me numër Nr.344/2 i datës 01.09.2009 në piken 1, ku ankuesi angazhohet si vozitës në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm.

Me datën 02.08.2018 Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka nxjerrë vendimin me numër 2-1725, sipas të cilit për disa zyrtarë në pozitën "Asistent i transportit", ndër ta edhe ankuesit, i 'u është aprovuar nivelizimi i koeficientit me titull të punës "Zyrtar për transport 4" me koeficient 6, ku i është lëshuar edhe akt emërimi për ndryshim të pozitës.

Tutje, Ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Përhershëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me datën 28.02.2020 ka nxjerrë vendimin me numër 2-355, sipas të cilit ankuesi nga pozita Zyrtar për transport nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, kthehet në pozitën e mëparshme si Zyrtar për transport dhe i hiqet shtesa prej njëqind (100) eurove.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin numër 2-355 të datës 28.02.2020, të Ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përhershëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me datën 09.03.2020 ka parashtruar ankesën ne Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Me datën 06.08.2020 Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka nxjerrë vendimin me numër Nr.411-21AK, me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

I pakënaqur me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datën 29.06.2020 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1240/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 09.07.2020, e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Me datën 20.07.2020, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri me datën 08.10.2020, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa me datën 20.08.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka njoftuar përfaqësuesin e tij për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke e udhëzuar se mund ti ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund ta filloj procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datën 13.12.2021 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.1485/2020, i cili në Këshill është pranuar me datën 16.12.2021, sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin e datës 20.08.2020 të KPSHMCK-së dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit me numër A.nr.176/2019 të datës 29.06.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me datën 17.01.2022, ka nxjerrë Vendimin me numër A.nr.1191/2021 sipas të cilit është shpallur jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, ndërsa me datën 11.01.2023 Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.280/2022 i cili në Këshill është pranuar me datën 13.01.2022, sipas të cilit e ka anuluar vendimin e këshillit dhe e ka kthyer çështjen e ankuesit në rishqyrtim dhe rivendosje.

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritore ka administruar këto prova:** Ankesën e ankuesit me numër 1240/2020 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 20.08.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.09.2020; Përgjigjen në ankesën e ankuesit e datës 14.05.2020; Kontratën e punës të datës 01.07.2009 të ankuesit; Vendimin me numër 344/2 të datës 01.09.2009; Kontratën e punës të datës 01.09.2009 të ankuesit; Shkresën zyrtare të datës 10.05.2011 lidhur me transferin e vozitësit; Kontratën e punës të datës 01.07.2011 të ankuesit; Akt emërimit e ankuesit të datës 02.04.2012; Vendimin me numër Nr.2-183 të datës 01.02.2016; Vendimin me numër 2-1725 të datës 02.08.2018; Akt emërimit e ankuesit të datës 02.08.2018; Vendimin me numër 2-355 të datës 28.02.2020; Ankesën e ankuesit e datës 10.03.2020 për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesën e datës 09.03.2020 të ankuesit; Vendimin me numër Nr.411-21AK të datës 06.08.2020; E-mailin zyrtar të datës 28.02.2020; Kartelën e nëpunësit publik për periudhën janar-mars 2020 për ankuesin; Akt emërimit e datës 28.02.2020 të ankuesit; Vendimin me numër 2-355 të datës 28.02.2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019 të datës 31.12.2019 për ankuesin; Aktgjykimin me numër A.nr.1485/2020 i datës 13.12.2020 i cili në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës është pranuar me datën 16.12.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të shqyrtuar ankesën e ankuesit Fehmi Aliu, *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar se ankuesi fillimisht sipas kontratës së punës me numër 415-ref 5/2-1-300 të datës 01.07.2009 ka pasur pozitën "Asistent i transportit-Vozitës", pranë Departamentit të infrastrukturës dhe shërbimeve teknike, Divizioni-Njësia e transportit në kuadër të MASHT-it, ndërsa nga shkresat e lëndës kolegji nuk ka gjetur prova se në lidhje me ndryshimin e pozitës nga "Asistent i transportit-Vozitës" në "Zyrtarë i transportit", përveç që është vendimi Nr.2-1725 i datës 02/08/2018, i cili vendim në pikën 6 specifikon si në vijim ' 'sistent i transportit me koeficient 5 i aprovohet nivelizimi i koeficientit me titull të punës :Zyrtarë për Transport 4 me koeficientë 6 ', ndërsa nga ky vendim mund të konstatohet fakti se nuk kemi të bëjmë me ndryshim të pozitës por vetëm me nivelizim të koeficientit, ndërsa për kolegjin është e qartë rrethana se nuk ka pasur procedura ligjore të parapara në Legjislacionin e Shërbimit Civil për ngritje në pozitë, ndërsa pozita që kishte mbajtur ankuesi para këtij vendimi e cila ishte pozitë "Asistent i transportit-Vozitës" në bazë të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nuk ka bërë pjesë në pozitën e shërbimit civil, pasi që është pozitë e cila kryen funksione mbështetëse siç është përcaktuar me dispozitat e nenit 4 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: "Personeli i punësuar nga institucionet e administratës në nivel qendror dhe komunal, përgjegjës për kryerjen e funksioneve mbështetëse dhe të mirëmbajtjes, nuk janë nëpunës civilë", po ashtu kjo pozitë nga shërbimi civil është përjashtuar edhe në bazë të Qarkores Administrative Nr. 01/2014 të datës 08.12.2014 të Ministrisë së Administratës Publike, sepse në pikën 4, nën pikën 1 është paraparë që pozitën "Vozitës" nuk hyjnë në kategorinë e nëpunësve civil, andaj Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka kompetencë që ti shqyrtoj vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil ashtu siç është përcaktuar me nenin 6 paragrafin 1 të Ligjit nr. 06/L -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se: "Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil".

Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në kuptim të pranueshmërisë së ankesës së ankuesit, ju referua edhe dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë përkatësisht nenit 2 ku përcaktohet se 3. *Nëpunës Civil- është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë.* 6. *Nëpunës administrativo-teknik- dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike", dhe si rrjedhojë ka konstatuar se pozita e ligjshme të cilën e mban ankuesi si "Asistent i transportit-Vozitës" hynë në kategorinë e nëpunësve administrativo teknik dhe mbështetës, gjegjësisht nuk është pozitë e shërbimit civil, andaj duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur*

Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbim Civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.176/2020 të datës 29.06.2020 të parashtruar nga ankuesi

Andaj, marr parasysh konstatimin si me lartë së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.176/2020 e datës 29.06.2020, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesja ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit publik, e njëjta udhëzohet për inicim të kontestit gjyqësor në gjykatën kompetente në pajtim me dispozitat e Ligjit të Punës, pasi që lënda nuk mund të bartët të gjykata kompetente ngase në këtë fazë mungon padia si kusht kryesor për fillimin e një procesi gjyqësor.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, si dhe bazuar në udhëzimin e gjykatës përmes vendimit A.nr.280/20222, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.176/2020, datë 13.02.2023.

Sabile Avdyli  
*Sabile Avdyli*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

